



**Nr i Protokolit 667**

**23.02.2021**

**Rahovec**

Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032, të datës 29.08.2011, neni 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it. Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018, Për Normativ për Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

## **Konkurs**

Për plotësimin e **1 pozite** të lirë të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2020/2021:  
**Mësimdhënës/e për Lëndën e Gjeografisë.**

### **Kushtet për konkurrim:**

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional sipas U.A.10/2018, Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.

### **Dokumentet e nevojshme:**

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar,
- Kopjet e çertifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë.
- Kopjen e ekstraktit të lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime.

### **Mënyra e aplikimit:**

Dokumentacioni i aplikimit, dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret /shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>

### **Lista Pritëse:**

Kandidatët të cilët grumbullojnë më shumë se 50 pikë, hynë në Listën pritëse si kandidat fitues, dhe nëse paraqitet nevoja për ndonjë pozitë të lirë – **Mësimdhënës/e për Lëndën e Gjeografisë**, kanë të drejtë të punësohen. Lista pritëse vlen vetëm gjatë vitit 2021.

### **Themelimi i marrëdhënies së punës:**

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës .

### **Aplikimi në konkurs:**

Afati i aplikimit fillon nga data 29.03.2021 dhe zgjat 15 ditë kalendarike dhe atë deri me datë 13.04.2021, deri në ora 16:00.

**Rahovec,**  
**23.02.2021**

**V.V**

**Avni Morina, Drejtor**

---